




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT
Nr. 02-060/01- 0014451-4/26 dt. 27.03.2026
Mitrovicë



Në bazë të neneve 12, paragrafi 2, alineja d, dhe 51 paragrafi 2, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale; neneve 13 paragrafi 1, nenparagrafi 1.4, 61 paragrafi 2, dhe 72, të Statutit të Komunës; nenit 4, të Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2016 Për procedurën e themelimit, organizimin dhe kompetencat e komiteteve konsultative në komuna; Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më dt. 27.03.2026, sjell këtë:

VENDIM

Për formimin e Komiteteve Konsultative

1. Me qëllim që qytetarët dhe grupet tjera të interesit të marrin pjesë në procesin e vendimmarrjes për interes publik të Komunës, Kuvendi i Komunës FORMON Komitetet Konsultative si në vijim:
 - 1.1 Komiteti për Shëndetësi, Mirëqenie Sociale dhe Persona me Aftësi të Kufizuara,
 - 1.2 Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport,
 - 1.3 Komiteti për Planifikim Urban, Mbrojtje të Ambientit, Shërbime Publike dhe Zhvillim Ekonomik.
2. Komitetet konsultative mund të dorëzojnë propozime nga fushë veprimtaritë e tyre në pajtim me Statutin e Komunës, përfshirë:
 - 2.1 Dhënien e propozimeve për rregullore të ndryshme,
 - 2.2 Hulumtime të ndryshme,
 - 2.3 Japin mendime dhe ide rreth iniciativave të ndërmarra nga Kryetari i Komunës, komitetet e përhershme apo Kuvendi i Komunës në fushën përkatëse,
 - 2.4 Paraqesin pikëpamjet dhe mendimet e qytetarëve te Kryetari i Komunës dhe Kuvendi i Komunës,
 - 2.5 Japin propozime për zgjedhjen e problemeve të identifikuara.
3. Propozimet nga pika 2 të këtij vendimi duhet të merren parasysh nga Kuvendi i Komunës për zhvillimin politikave lokale.
4. Komitetet përbehen nga 5 deri 7 anëtarë dhe duhet të reflektojë përfaqësimin gjinor.
5. Kuvendi i Komunës shpall konkurs publik për anëtarësimin e anëtarëve në këto komitete konsultative, konkursi përcakton kushtet dhe kriteret e konkurrimit.
6. Të drejtë konkurrimi kanë të gjithë qytetarët e Komunës së Mitrovicës dhe përfaqësuesit e organizatave joqeveritare.
7. Kandidati i cili konkurren që të bëhet anëtar i këtyre komiteteve konsultative duhet të jetë qytetar i Komunës së Mitrovicës dhe të ketë përvojë profesionale për pjesëmarrje në konsultime për fushën për të cilën themelohet komiteti konsultativ.
8. Për perzgjedhjen e anëtarëve të komiteteve konsultative FORMOHET Panelit perzgjedhës në këtë përbërje:

- 1) Gëzim Stavileci (anëtar i Kuvendit),
 - 2) Bajram Istrefi (anëtar i Kuvendit),
 - 3) Oltion Ahmeti (anëtar i Kuvendit),
 - 4) Fitore Mehmeti (nga Ekzekutivi), dhe
 - 5) Xhyla Haziri (nga Shoqëria Civile).
9. Paneli përzgjedhës në bazë të rezultateve të konkursit, do t'i propozojë Kuvendit të Komunës listën me anëtarët për komitetet konsultative.
10. Kuvendi i Komunës, në bazë të listës së propozuar nga Paneli përzgjedhës, me vendim emëron anëtarët e këtyre komiteteve konsultative, të cilët nga përbëja e anëtarëve zgjedhin kryesuesin.
11. Mandati i anëtarëve të këtyre komiteteve konsultative është 4 (katër) vjeçar.
12. Vendimi shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë

Kryesuesi i Kuvendit


Safet KAMBERI



Dorëzohet:

1 x 1 Kryesuesit të Kuvendit

1 x 1 MAPL

1 x 1 Arkivit

**Kopje: Kryetarit të Komunës
Anëtarëve të Panelit**